



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1149/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Arzen Bytyqit kandidat për asamblenë komunale në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Arzen Bytyqit kandidat për asamblenë komunale në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

URDHËROHET KQZ që të rinumëroj fletëvotimet në Vendvotimin 1709C/02R dhe dhe Qendrën e votimit 1724C/01R /02R/ 03R dhe 04/D dhe ky numërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

A R S Y E T I M

PZAP-i me datën 03.12.2013 ka pranuar dy ankesa nga Arzen Bytyqit ku në ankesën A nr. 1149/2013 theksohet se në vendvotimin 1709C/02R nuk i janë paraqitur votat sipas votimeve dhe se subjekti politik AAK këtu ka marrë 75 vota ndërsa parashtruesi i ankesës thekson se ka marrë 24 vota. Në formularin e KQZ-së shkruan 50 vota Arzen Bytyqi 4 vota ndërsa në publikimin e KQZ-së 0 votë.

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se Osman Byryqi zv, koordinator deklaron se se AAK i ka pasur 75 vota ndërsa kandidati Arzen Byryqi 24 vota

Në ankesën me nr A nr. 1150/2013 theksohet se sipas denoncimit të bërë nga organet kompetente si policia e Kosovës dhe Prokurori i Shtetit në këtë vendvotim është konstatuar se është ndërruar rezultati i të gjithë kandidatëve duke e përfshirë edhe parashtruesin e ankesës Arzen Bytyqin

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit gjeti se:

- **ankesat janë të bazuara**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga shqyrtimi dhe hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka vërejtur se kandidatit në fjalë i mungojnë votat pasi që në FRK ka numër tjetër të votave nga ajo që është shpallur nga KQZ-ja. PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotime të lartcekura. Andaj nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve eventuale të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 1149/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i